

LIGJ
Nr. 90/2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E
SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 77, “Rimbursimi i TVSH-së”, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, administrata tatimore kryen procedurën e rimbursimit, siç përcaktohet për këtë qëllim në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Administrata tatimore, para se të procedojë një kërkesë për rimbursim të TVSH-së për një person të tatueshëm, ka të drejtë ta detyrojë atë person të provojë që qëllimi i veprimtarisë ekonomike është realizimi i transaksioneve të tatueshme, që i japin të drejtën e zbritjes së TVSH-së.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9202, datë 30.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani